



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0010215/25 dt. 27.02.2025
Mitrovicë

PROCESVERBAL
Nga mbledhja e 38-të e rregullt e Kuvendit të Komunës

Koha: 27.02.2025 ora 10:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Vesa Broja, Fisnik Suma, Majlinda Kurti, Xhafer Preteni, Florina Çitaku, Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Fisnik Krasniqi, Hamdi Hasani, Egzon Hamza, Lavdim Zeneli, Nafije Rexha, Mentor Vinarci, Hysen Muzliukaj, Naser Muja, Kushtrim Zeneli, Ekrem Sadiku, Armend Begu, Elidiana Budini Haziri, Jeton Zeneli, Erseka Barani Xhylljeta Imeri, Flutura Beka Kamberaj, Gazmend Asllani, Sevdaim Uka, Muhamed Hoti, Oltion Ahmeti, Jeton Ujkani, Vesel Neziri dhe Ardita Aliu.

Nënkryetari i Komunës Z. Arian Tahiri

Drejtorët e Drejtorive

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Munguan: Faruk Mujka, Shkurta Shosholli Musa, Shkëlqim Ibrahim, Gjergj Beka dhe Xhevrija Bahtiri Ademi.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesja Kuvendit Znj. Vesa Broja, e cila fillimisht përshëndeti Nënkyetarin e Komunës, anëtarët e Kuvendit, mediat dhe të pranishmit tjerë. Kryesuesja e Kuvendit në vazhdim theksoi se zbatim të nenit 43, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale; nenit 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 5, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, dhe nenit 52, paragrafi 1, të Statutit të Komunës kam thirrur mbledhjen e 38-të të Kuvendit të Komunës me rendin e ditës të paraparë me thirrje, dhe po hapi diskutimin për rendin e ditës.

Xhafer Preteni: Ditë më parë qyteti i Mitrovicës dhe e gjithë Kosova humbi një njeri me vlera të mëdha, një aktivist të palodhur, një veprimtar të madh, Kryetarin e Shoqates së të zhdukurve të luftës, “Zori i Prinderve” z. Bajram Qerkinin i cili dhimbjen e rëndë të humbjes së djalit të tij, poashtu të zhdukur gjatë luftës e ktheu në forcë për angazhim për të zbardhur fatin e mijërave të zhdukurve tjerë gjatë luftës për 26 vite rresht. Andaj propozoj që me një minutë heshtje, Kuvendi i Komunës ta nderoj personalitetin e këtij njeriu të madh të qytetit tonë.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja ftoj kuvendin për Një minutë heshtjeje

Lavdi!

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja propozoj tw vazhdohet me diskutime për rend dite.

Flutura Beka Kamberaj: Shqetësimi im ka të bëj lidhur me mos prezantimin e hartës zonale nga Drejtoria e Urbanizmit, unë kam kërkuar një përgjigje nga drejtoria përkatëse për arsyen pse, pavarësisht se harta është përfunduar dhe të gjitha procedurat janë realizuar, ajo nuk është prezantuar ende. Në këtë kontekst, theksoj se kërkesa vjen si rezultat i shqetësimeve të qytetarëve dhe është një çështje që kërkon shpjegim dhe transparencë.

Armend Begu: Unë edhe në seancat e kaluara e kam ngrit këtë shqetësim, shqetësimi im ka të bëjë me një çështje të rëndësishme për sigurinë e qytetarëve dhe menaxhimin e qenve endacakë. Shqetësimi dhe rreziku i qenve endacakë është se kemi të bëjmë me rrezikun që paraqesin qentë endacakë për qytetarët dhe kërkohej trajtimi i kësaj çështjeje me seriozitet, sa jemi të informuar ne, janë raportuar rreth 17 raste të kafshimit të qytetarëve nga kafshët që ndodhen në qytet në vitin 2024. Po ashtu ne e dimë se ekziston një kontratë që ka të bëjë me menaxhimin e kafshëve për një periudhë njëvjeçare dhe vlera e saj është 320,000 €. Andaj unë propozoj që kjo çështje të shtrohet në rendin e ditës sot dhe të diskutohet më gjerësisht.

Nënkryetari i Komunës, z. Arian Tahiri: Është një çështje shumë e rëndësishme, problemi nuk është vetëm i Mitrovicës, por një çështje që kërkon një trajtim më të gjerë dhe një koordinim më të mirë ndërmjet komunave dhe niveleve shtetërore. Problemi i qenve endacakë e pranoj se është një sfidë e madhe, jo vetëm për qytetin e Mitrovicës, por edhe për shumë qytete të tjera, tjetra është se qenët po barten prej një qyteti në qytetin tjetër, nëse Mitrovica po i trajton komuna tjera periferike nuk i trajtojnë, mandej i grumbullojnë e i bien. Problem ndonjëherë ka edhe tek vështirësitë në ligjet që lejojnë vetëm të kapen dhe të trajtohen qentë, për shkak të procedurave dhe që e detyrojnë me dëshmi të kthejë kafshën në të njëjtin vend ku e ka marrë pas një periudhe të caktuar kohore p.sh. 20 ditë. Një kontratë njëvjeçare që ka ekzistuar për menaxhimin dhe kontrollin e qenve endacakë, kërkoj nga drejtori të paraqesë një raport më të detajuar për të parë se si ka funksionuar kjo kontratë deri tani, çfarë rezultate ka dhënë dhe cilat janë hapat e ardhshëm. Po ashtu kërkoj që drejtori të prezantojë një raport që do të ndihmojë në vlerësimin e situatës dhe procesit të menaxhimit të qenve endacakë, duke u fokusuar në aspektet e financave dhe procedurave. Përtej saj ne i kemi nda mjetet prapë që me u procesu dhe me u procedu kontrata, me pas kontratën prapë për me i menaxhu e me i trajtu qenët endacakë. Mirëpo ky problem nuk zgjidhet nëse e menaxhon këtë problem vetëm një komunë, ose i menaxhoj tri-katër komuna në nivel vendi, pra ky problem duhet me u menaxhu në kuptimin nacional.

Armend Begu: Meqenëse Nënkryetari theksoj që drejtori me sjell Raportin e detajuar për seancën e radhës atëherë pajtohem që për seancën e radhës të jetë si pikë e rendit të ditës.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Atëherë, mbetet që për seancën e radhës drejtori me sjell një raport sa i përket kontratës në fjalë, se për çështje tjera nuk ka kompetencat drejtori, po sqarime për kontratën në fjalë se qysh kanë shku procedurat edhe ku jena me trajtimin e qenve ndacak me na ardhë si raport.

Edison Tërnavaj: Sa i përket Çështjes së hartës zonale është çështje që ne veçse e kemi përfundua edhe me pëlqimin e Ministrisë, i kemi përfundua të gjitha çështjet që kanë qenë edhe përmes komunës mirëpo datën e saktë nuk mund me ditë, po është diku afër një muaji e gjysmë që e kemi pranua një ankesë prej investimeve që janë bërë në pjesën e Shalës nga "Suvi Kosova" ku na edhe si pjesë e strategjisë planeve zhvillimore komunal, e kemi pas zonën e shalës për trajtim edhe për turizëm, edhe për pjesën e hapësirave d.m.th pyjore që të ruhen, mirëpo çështja është që një problematikë që ka ndodhë ndër vite mund të them dhjetë vitet e fundit ka ndodhë d.m.th një ndërtim afër fluturakeve të "Suvi Kosovës" dhe si problematikë e saj ka shkuar ankesa edhe në Ministrinë e Planifikimit që jemi bashkërisht duke u mundu me zgjidh që këtë problem në zona të caktuara ku fluturakët janë vendosur të trajtohet çështja e ndërtimit edhe strategjisë për turizëm në pjesën e Shalës, ndërsa sa i përket zonave tjera në qytet që i kemi ose në zonat urbane nuk kemi

telashe, edhe pse kemi pranuar ankesa edhe prej qytetarëve pasi që është marrë pëlqimi prej ministrisë, por besoj që shpejt, nëse këtë seancë nuk kemi mbërri me prurje, po presim një konfirmim prej Ministrisë së Planifikimit që çështja e "Suvi Kosova", investimeve për energji të ripërtëritshme që edhe në gjeoportale kush ka pas mundësi me pa, është vendosë një pjesë e madhe, 80% të Shalës që të përdoren për energji të ripërtëritshme, për panela solare dhe me energji me erë mirëpo po kemi problem, që në ato zona, si strategji që i kemi në plan e zhvillimit komunal, në hartën zonale me e shfrytëzua edhe për turizëm dhe për ndërtim. Këtë çështje jemi duke e diskutua dhe duke e trajtua edhe në Ministri bashkërisht që besoj që ndoshta muajin mars me prurje ndoshta edhe për Kuvend.

Flutura Beka Kamberaj: Ankesa a ka ardhë gjatë afatit të ankesave apo pastaj.

Edison Tërnavaj: Ankesa ka ardhur pas kohës, po ankesa na është paraqitë edhe neve si drejtori komunal, mirëpo edhe në Ministri. Duke marrë parasysh investimet milionëshe që janë bërë atje, ka ardhur te problematika edhe ngecja, se d.m.th edhe përmes ministrisë edhe neve. Kjo është arsyeja që neve na ka ndalë.

Ekrem Sadiku: Ndoshta keqkuptova, mirëpo m'u duk që the në bazë të strategjisë për energji të ripërtëritshme, Shala parashihet rreth 80% të vendosen me erë, mos e ke informatën e gabuar, apo të kuptova në gabim, sepse jena tu fol për ndërtime të cilat janë në parkun e energjisë jo për pjesën tjetër, sepse Shala llogaritet shumë pjesë me e madhe.

Edison Tërnavaj: 80%, thashë pjesa e Shalës është e parapare me strategji jo me planë zhvillimor komunal, po me hartë zonale edhe me strategjinë e Ministrisë së planifikimit, po flasim për planin hapësinor në nivel të Kosovës. Ajo nuk nënkupton me erë, janë të përfshira edhe me energji, me erë dhe me panela solar. I kemi në gjeoportale të caktuara, me korniza kartorë besoj që kush është më i informuar mundet me edhe me e kuptu, ku tregoj pjesën e Selacit, Bares, Kovaçicës, Kaçanollit, Bajgorës, janë disa pjesë që janë me zona të favorshme në bazë e analizave që i kanë bërë në studimin e fizibilitetit dhe i kanë caktua këto zona me qenë për këtë shfrytëzim, për këtë destinim. E kjo na ka ndodhë neve, na ka sjellë telashe se në ato zona kemi ndërtime edhe të mëhershme, edhe të paraluftës edhe pas luftës dhe që ka vazhduar me u ndërtua në atë zonë, po tash na kemi problem që investitorë që kanë zhvillu investime në ato zona e kanë problem, afërsinë e ndërtimeve që janë afër fluturakeve që sipas tyre ligji d.m.th ndërkombëtar, që d.m.th nuk e lejon me pas në rreze 500 m afër fluturakeve ndërtime që janë të vendosura atje. Kjo është një çështje që mes ministrisë po mundohemi me zgjedhë edhe me e trajtua tutje.

Elidiana Budini Haziri: Drejtor, më ke mbetur borxh një përgjigje që e kam që tri vite, pra jam duke e pritur. Mandatin e kaluar kemi dhënë pasuri të paluajtshme të komunës, që sot është në shfrytëzim, dua të na informoni se sa po përfiton komuna, a po respektohen ato marrëveshje, pra këtë përgjigje jam duke e pritur që tri vite prej teje, e për seancën e radhës t'u kisha lutur me e futi si pikë të rendit të ditës, me dhënë një raport të detajuar që të jemi të informuar të gjithë.

Edison Tërnavaj: Besoj që në seancën e ardhshme ta kemi të gatshme. Të kam mbetur borxh, të kam tregua dy-tri herë që e kemi përfundua, po pse kur nuk e kemi sjellë nuk e di pse, mirëpo e dimë shumë mirë që edhe vitin e kaluar kemi pas problem për me i inkasua ato të hyra prej kontratave të mëhershme, se kanë qenë të skadume dhe kemi pas problem në bazë të Rregullores, që e kemi ndryshua vitin e kaluar nëse të kujtohet për objektet d.m.th që janë pronësi të komunës edhe çështjen e qirasë, metrin katror në zonën urbane dhe në zonën suburbane që i kemi nda. Për atë arsye kemi ngecë pak me kontrata edhe kam kërku e dini shumë mirë formimin e një komisioni i cili duhet me qenë i përbashkët prej asamblesë edhe prej ekzekutivit, që ato kontrata që janë me i rishiku a mundën me u vazhduar apo me u shpëput dhe me i vu në ankand për investitorë tjerë.

Elidiana Budini Haziri: Atëherë, i bie nëse ju dhe keni problem për m'i analizu ato lloj kontratash ty si drejtor, t'u është dashur prej ekzekutivit me kërkuar me kriju një komision prej Kuvendit pse e ke zvarrit procedurën tri vite, nëse thua ligji është bërë vitin e kaluar, i bie prej vitit

të kaluar ju është dashtë me kërku te ky Kuvend krijimin e komisionit dhe me vazhdu punën. Që tri vite ta kam kërkuar një përgjigje, sot u inkasuan, nuk u inkasuan, kur e keni në plan katër vjet mandat, atë që nuk u inkasuan me i marrë ditën e fundit në fushatë, tctor nëntor veç po fillojnë zgjedhjet.

Edison Tërnavaj: E nderuar, po flasim për vitin 2020, kur kanë skadua kontratat. Ju besoj keni qenë pjesë e Kuvendit nuk është vitit 2022 as 2023 që kanë skaduar këto kontrata, por prej 2020 pra më thoni ju ku keni qenë ju që nuk e keni ngrit zërin derisa unë jam marrë me këtë çështje.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: Drejtor ju na e sjellni raportin edhe nëse jeni të sigurt që duhet të formohet një komision nga kuvendi dhe ekzekutivi ju lutem propozoni formimin e komisionit.

Hysen Muzliukaj: Jemi në muajin shkurt, besoj që i keni parapa raportet e Komisioneve të aksionarëve të Ndërmarrje Publike. A i keni parapa me i sjell në muajin mars, apo është dashtë ti kemi në këtë seancë nëse jo, atëherë, le të jetë si konkluzion i kësaj mbledhje që në muajin mars me na ardh raportet sepse nëse e kujtoni vitin e kaluar ka pas mungesë të raporteve të disa ndërmarrjeve publike.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: z. Muzliukaj, sot si pikë të rendit të ditës e kemi formimin e Komisioni për Planin e Punës të Kuvendit për vitin 2025 andaj po besoj që Grupi Punues e vendos edhe në kalendar se kur me i sjell raportet secili komision. Ne mundem me lë si konkluzion m'i kërku tash që për seancën e ardhshme me na ardhë, por prap po besoj që është më mirë që komisioni i cili formohet me vendosë në kalendar se kur me na u sjell raportet.

Atëherë pra u dakorduar që për kërkesën e z. Begu dhe znj. Budini Haziri të na sillen raportet në seancën e ardhshme ndërsa për çështjen e hartave zonale e morëm përgjigjen dhe po besojmë që përfundohet deri në seancën e radhës, kështu që po vazhdojm me votim, pra e hedh në votim rendin e ditës si në vijim:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim vendim për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025
3. Propozim Vendim për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2025
4. Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024
5. Raport financiar për periudhën janar-dhjetor 2024
6. Pyetje dhe përgjigje

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi unanimisht të miratuar Rendin e ditës.

Pika 1

Kryesuesja e Kuvendit hapi diskutimin për Procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

Rezultati i votimit: 27 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja sa i përket Propozim vendimit për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025, është i njëjti propozim si tri viteve të kaluara, por nëse ka dikush ndonjë propozim po e hap për diskutim.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja e konstatoi të miratuar vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve të rregullta të Kuvendit të Komunës për vitin 2025.

Pika 3

Kryesuesja Vesa Broja: Sa i përket Propozim vendimit për formimin e Grupit Punues Për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, Kuvendi e ka kompetencën që ta formojë këtë grup punues, në propozim e kemi lënë që me caktua se sa anëtarë kanë me marrë pjesë, unë po besoj që është korrekte të secila parti politike, me qenë të përfaqësuar në këtë komision, pra ti ketë shtatë anëtarë, jemi 7 parti pra nëse jeni të pajtimit që ky grup të përbëhet nga 7 anëtarë nëse jo diskutimi është i hapur nëse keni ndonjë propozim tjetër, po e hap për diskutim.

Hysen Muzliukaj: Besoj është hera e tretë që e ngriti këtë shqetësim mendoj që është tepër vonë që sot të formohet komisioni, të gjithë e dimë që plani bëhet në fund vit për fillim vit. Ne mund ti miratojmë dhe të ecim tutje mirëpo nuk është korrekte sepse është tepër vonë që në muajin shkurt të fillojmë me formim të komisionit që të bëhet plani deri sa e dimë që ky vit është vit zgjedhor i zgjedhjeve lokale e kështu që i bie që ne po e bëjmë një plan për rreth 4 muaj pra për këtë nuk mendoj se është korrekte dhe procedualisht është shumë vonë.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: z. Muzliukaj keni të drejtë mirëpo duke e marrur parasysh që në dhjetor nuk ka qenë pikë e rendit të ditës unë mendoj që është lëshim i komisionit të kaluar që nuk e kanë vendos në kalendar që në muajin dhjetor të jetë si pikë e rendit të ditës formimi i grupit punues për hartimin e Planit të punës të kuvendit të komunës për vitin 2025. Edhe këtë pjesë e kam menduar se a jemi vonë mirëpo prap unë mendoj që komisioni duhet të formohet dhe duke e pasur parasysh komisioni që në plan të vendosin muajin dhjetor për formimin e komisionit për vitin e ardhshëm. Në muajin janar nuk kemi mbajtur mbledhje kështu që unë po mendoj që të vazhdojmë me këtë pikë.

Atëherë meqenëse nuk ka propozime tjera unë kërkojë nga secila parti të jep emrin e të propozuarit që do ta përfaqësoj partin e vetë, atëherë fillojmë me GP të PDK-së:

Fisnik Suma: Për anëtarë të GP-së nga radhët e PDK-së propozoj: z. Shkëqlim Ibrahim.

Hysen Muzliukaj: Për anëtarë të GP-së nga radhët e VV-së propozoj z. Armend Begu.

Xhyljeta Imeri: Për anëtarë të GP-së nga radhët e LDK-së propozoj znj. Flutura Beka Kamberaj.

Kryesuesja Vesa Broja: Për anëtarë të GP-së nga radhët e FD-së propozoj z. Jeton Ujkani.

Kryesuesja Vesa Broja: Për anëtarë të GP-së nga radhët e PD-së propozoj z. Vesel Neziri.

Kryesuesja Vesa Broja: Për anëtarë të GP-së nga radhët e AKR-së propozoj z. Gjergj Beka.

Kryesuesja Vesa Broja: Për anëtarë të GP-së nga radhët e AAK-së propozoj znj. Ardita Aliu.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja thekson se për shkak të kuotës gjinore duhet një propozim të ndryshohet. Unë propozoj që PDK të bëjë ndryshimin e propozimit.

Fisnik Suma: Për anëtarë të GP-së nga radhët e PDK-së propozoj: znj. Nazmije Sejdiu.

Kryesuesja hedh në votim propozimin Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025, në përbërje:

1. Nazmije Sejdiu,
2. Armend Begu,
3. Flutura Beka Kamberaj,
4. Vesel Neziri,
5. Jeton Ujkani,
6. Gjergj Beka, dhe
7. Ardita Aliu.

Rezultati i votimit: 29 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja konstaton se u miratua unanimisht Vendimi për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2025.

Pika e 4

Kryesuesja hapë diskutimin lidhur me Raportin e punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Flutura Beka Kamberaj: Një falënderim sekretariatit për punën dhe angazhimin e tyre, njëkohësisht kisha dashtë me ngritë si shqetësim çështjen e mos mbajtjes së mbledhjeve të Komiteteteve Funksionale dhe komiteteve konsultative, ish dashtë me mendu një formë stimuluese ndaj anëtarëve të këtyre komiteteve, për me jep edhe ata kontributin e tyre secili në fushën e vet për çka janë caktuar. Po ashtu gjithë këtyre, po njëkohësisht edhe zvogëlimi i mbledhjeve të komiteteve dhe komisioneve të aksionarëve, kështu që komuna duhet me punu dhe me mendu një drejtim të caktuar për me i përkrahë këto komitete, ku për shkak të cilës janë mbetë pa funksionu shumë komitete edhe komisione.

Kryesuesja e Kuvendit znj.Vesa Broja: Po jemi në dijeni të gjithë për çështjen në fjalë, është çështja e Ligjit të ri të pagave.

Flutura Beka Kamberaj: E dini këtë të gjithë, mirëpo komunat e tjera e kanë gjet një formë, një zgjidhje, kështu që ish dashtë me i diskutu këtë. Unë po besoj që edhe ju e keni pa pak a shumë vendimin e Komunës së Prishtinës edhe të disa komunave tjera edhe Komuna jonë ish dashtë me shiku një mundësi për me i përkrahë në mënyrë që me funksionalizu këto komitete, se luajnë një rol të caktuar në qytet.

Kryesuesja e Kuvendit znj.Vesa Broja: Po besoj se është çështje për diskutim znj.Beka Kamberaj, po edhe unë jam e njoftuar s'e di a e kam informatën e saktë a jo, veç në diskutime e sipër jemi marr edhe ne me këtë me këtë punë, më është thënë që Komuna e Prishtinës e ka njëfarë linje të veçantë, do vendime të veçanta që komuna tjera nuk e di sa mundemi m'i pas. Unë po mendoj që Kryetari duhet te formoj një komision, apo komisioni i formuar duhet me shiku se kompetencë e kujt është. Edhe njëherë po e theksoj se është temë që duhet të diskutohet po se jemi në dijeni se për shkak të mos pagesës kanë mbet pa funksionu shumë komitete dhe komisione.

Nëse nuk ka diskutime të tjera, atëherë kush është që të miratohet Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Rezultati i votimit:28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja konstaton të miratuar Raporti i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2024.

Pika e 5

Kryesuesja hapë diskutimin lidhur me Raportin financiar për periudhën janar-dhjetor 2024.

Fadil Veseli: Te të hyrat vetanake, realizimi është 96.91%, realisht është mirë, nuk është keq. Te tabela numër një, sipas drejtorive, grumbullimi i të hyrave, është i mirë edhe për ekzekutivin,

që secili e sheh veten se ku është, d.m.th realizimin sipas planit që e kanë parapa vetë. Pra sa i përket realizimit të planit buxhetor me 96.91%, është një rezultat pozitiv, megjithatë ka hapësirë për përmirësim. Ky nivel realizimi është shumë i lartë, por gjithsesi, mund të shqyrtohet mundësia për të arritur më shumë, poashtu në këtë tabelë shifet se janë futur edhe të hyrat nga gjobat e gjykatës dhe dënimet e policisë që janë një pjesë e të ardhurave të komunës, duke arritur në një total prej 483,000 €. Këto të hyra kanë hy në buxhet të komunës janë në interes dhe në menaxhim të komunës dhe janë të ligjshme. Çka është më pozitive këtu është, ta zëmë se nuk figurojnë më të hyrat prej Kompanisë "Uniteti", deri në vitin e ka kaluar kemi pas bartje të hyrave të kompanisë në komunë, a realisht kanë qenë të dedikuara për Kompaninë "Uniteti". Kur flitet për heqjen e të hyrave nga gjobat dhe dënimet e policisë, përqindja e realizimit të planit bie në 82.19%. Ku shihet ngecja dhe që e kanë barrën më të madhe. Në menaxhimin e financave, siç është Drejtoria e Buxhetit dhe e Financave përqindja e realizimit është e lartë, rreth 98.53%, që është një rezultat shumë i mirë, duke treguar se shumica e planifikimeve janë realizuar siç është parashikuar. Kam prit që do të ketë të hyra më shumë mirëpo një ngatërrim e ka bërë edhe qeveria veçanërisht në lidhje me taksat dhe kategoritë e taksave, dhe kjo ka pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në financat e komunës. Drejtoria e urbanizimit, ku ka pasur një detyrim për të siguruar një shumë prej 1,100,000 € megjithatë, realizimi në këtë drejtori ka qenë më i ulët, rreth 62.47%, që është një nivel më i ulët krahasuar me drejtoritë e tjera, arsyeja është se Drejtoria e Urbanizimit nuk ka mundur të realizojë më shumë nga këto mjete për shkak të kushteve ligjore dhe rregulloreve që duhet të plotësohen për të marrë leje ose nëse nuk ka të interesuar. Në faqe katërbëdhjetë (Tab nr. 8) këtu shpenzimet sipas kategorive. Investimet kapitale që ishin të planifikuara për vitin 2024, që ishin në total 7,114,000 €. Mirëpo sipas tabelës, është raportuar se investimet kapitale janë realizuar në masën 81.81%, një përqindje që siç përmendet duket e mirë në pamje të parë dhe tregon një progres të konsiderueshëm në realizimin e projekteve. Pjesa më shqetësuese e këtij diskutimi është ndikimi i përmbaruesve privatë, të cilët po tërheqin një pjesë të konsiderueshme të mjeteve që ishin paraparë për investime kapitale, kjo ndodh për shkak të një kontrate kolektive, e cila ka detyruar qeverinë dhe komunat të paguajnë një pjesë të konsiderueshme të mjeteve për pagat dhe mëditjet e mësimdhënësve. Shuma e tërhequr nga përmbaruesit privatë shihet se është 2,200,000 € që ishin paraparë për investime kapitale janë tërhequr nga përmbaruesit privatë. Nëse heqim këtë shumë të tërhequr nga përmbaruesit privatë, përqindja e realizimit të investimeve kapitale do të bjerë ndjeshëm. Ky është një problem që është përsëritur vit pas viti dhe ka krijuar një barrë të vazhdueshme për komunat dhe për qeverinë. Sipas këtij diskutimi, është e qartë që ky problem është një "defekt" i sistemit që duhet të pastrohet, dhe se kjo është një çështje që kërkon zgjidhje urgjente, por sic po shihet dikujt po i intereson kjo gjendje.

Hysen Muzliukaj: E kam theksua dhe dje në KPI, ka të bëjë me tabelën 1.2 krahasimi i inkasimit të hyrave vetanake me planifikim sipas drejtorive, po e përsëris edhe këtu, kam pritë që do të përmirësohet, kjo nuk është përqindja reale në 96.91% për arsye se planifikimi prej dënimeve të Policisë, gjobat nga gjykatat dhe agjencia e pyjeve janë kanë të përfshira në Drejtorinë për Zhvillim Ekonomik mendoj edhe tash nëse e kanë bërë planifikimin sa kanë me qenë të hyra edhe përcjelljen sa kanë me u rritë, me këtë po e mashtron vetën, se nuk është përqindja e saktë kjo e inkasimit të hyrave vetanake. Nëse e shtoni të zhvillimi ekonomik, nuk del kjo përqindje, del tjetër përqindje, e theksova edhe më lartë se këtë çështje e kam ngrit edhe në KPF por meqenëse nuk e keni përmirësuar dua ta ngris edhe sot dhe po besoj që nuk e publikoni si dokument pa e përmirësuar. Unë e di që një kërkesë e kam pas për tabelat, pra që me na i dërgua tabelat e pagesave përmes përmbarimit që janë marrë. Me e-mailin që na u ka dërgua, është për periudhën janar-shtator me arsyetim se Sistemi i pagesave SIMFK nga muaji tetor nuk ofron qasje të pagesat e caktuara sipas procedurave përmbarimore nga Ministria e Financës, punës dhe transfereve, pra kjo nuk qëndron. Unë personalisht jam interesuar për këtë pra duhet të ketë një shkresë zyrtare për

të pasur mundësi për të pasur qasje në atë. Pra ju na keni dërgu email zyrtare dhe unë them se nëse na dërgoni një email zyrtare, po na qitni pak para aktit të kryer profesionalisht nuk jam duke diskutuar fare politikisht, andaj po besoj që nuk kish dashtë prej sekretarisë ose prej kujt do qoftë, ishte dashtë me u interesua pak më shumë se kush ua ka dërgua juve atë pyeteni se nuk është siç kanë thënë. Unë kam pyet Ministrinë të Financave dhe nuk qëndron ky version. Duhet me ba kërkesë, në mënyrë që me pas qasje komuna në sistem. Këto vërejtje i kam, a na e sillni raportin për tetor, nëntor dhe dhjetor, dhe a e bini në seancën e ardhshme të kompletuar me këta muaj apo i bashkëngjiten kur ta publikoni, kjo përqindje po ju them edhe një herë, mos e publikoni në diku se nuk është e saktë.

Xhyljcta Imeri: Faleminderit për përgatitjen e raportit të financiar, besoj që ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për shkak të kontratave kolektive të gjitha komunat e Kosovës janë duke pësuar në investimet kapitale nga përmbaruesit, sipas këtij raporti në Komunën tonë janë investime kapitale 81% që realisht diku rreth 50% janë investime reale, kurse 31% janë urdhra përmbarimorë. Mua më intereson çka do të ndodhë me objektet, e veçanërisht objektet shkollore, të cilave ju kanë marrë mjetet? në të ardhmen më intereson si do të realizohen këto projekte, kur ne e dimë që për vitin dy mijë e njëzet e pesë janë të planifikuara projekte tjera. Gjithashtu, kur jemi këtu tek raporti, besoj që lihet edhe Shkolla dhe Çerdhja në Shipol, për të cilën lirisht besoj që mund të shkruajmë një tregim. Na ishte një herë një çerdhe, e cila është nisur në vitin 2020 në këtë trend si jemi duke shkuar është e papranueshme që për sa vite mos me arrit me u funksionalizu. Atëherë kërkoj nga Drejtoria e Arsimit që t'i gjejë të gjitha mekanizmat, t'i përdor që ta funksionalizojë këtë çerdhe, gjithashtu të hapë vende pune për psikologët nëpër shkolla dhe për mësues mbështetës për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Kushtrim Zeneli: Kërkoj sqarime për disa shifra dhe tabela, veçanërisht për një shumë të caktuar, 8,470 €, e cila është përmendur si shtesë e performancës fq. 8, pra a mund ta dimë se për cilat shtesa të performancës bëhet fjalë dhe cila është arsyeja që janë dhanë këto mjete. Pastaj fq 9 sqarim mbi një shumë të madhe të përmendur në raportin financiar, që figuron se pajisjet tjera janë mbi 102,000 €, pa asnjë specifikim të mëtejshëm për drejtorinë ose pajisjet për të cilat janë shpenzuar deri sa kemi raste tjera ndryshe nga shuma e përgjithshme prej 100,000 €, ku përmenden shuma të vogla për pajisje të tjera si 72 €, 75 €, 100 €, pra a mundeni të na sqaroni se shuma prej 102,000 € për cilat drejtori bëhet fjalë, për cilat pajisje që të kemi edhe ne më të qartë. Pastaj një shqetësim për shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore, ku është përmendur një shumë prej 105,000 €, ndërsa lajmet publike tregojnë se disa shkolla, si Shkolla "Ismail Qemali", dhe "Migjeni", kanë përjetuar mungesë ngrohjeje dhe klimës, duke përmendur madje mundësinë e ndërprerjes së procesit mësimor në shkollën "Migjeni" dhe në Shkollën "Avdullah Shabani", këshilli i prindërve e bën luterjen e klasës. Kjo pra është një çështje që kërkon shpjegim për përdorimin e kësaj shume, duke pasur parasysh që disa shkolla po kanë mungesa ejtë investimeve për mirëmbajtjen dhe ngrohjen. Meqenëse u përmend qerdhja, a është e vërtetë se janë pagua dy operatorë ekonomikë për të njëjtën Çerdhe dhe për të njëjtën punë, unë nuk po them që është e vërtetë mirëpo vetëm po pyes.

Nënkryetari i Komunës z. Arian Tahiri: Po e filloj tek çështjet që i ngriti z. Zeneli, pra unë po kërkoj që me ja dërgua një raport të detajuar për të gjitha pagesat ku janë bërë dhe mendoj që është më korrekt, më transparente dhe është përgjegjësia më e saktë dhe se më tej e dimë se ku mu drejtua edhe me kërkuar llogaridhënien, kështu që nëse është mundësia për në seancën tjetër, le të jetë si kërkesë për Drejtorinë së Financave që me e sjell raportin e detajuar për të gjitha pagesat me numër të kodit, me numër të faturës të operatorit, ku janë realizua edhe pse janë realizua edhe mandej me i pas ju si anëtarë të asamblesë komunale edhe me ditë të saktë për secilën pagesë ku është bërë dhe për çfarë arsye është bërë dhe të cilëve operatorë është bërë. Ndërsa sa i përket projektit të çerdes ka pasur probleme të mëdha që nga fillimi, në fazën e parë të projektit ka pasur probleme

me operatorin që e ka marrë projektin, i cili ka refuzuar të realizojë punimet për shkak të çmimeve që ishin parashikuar për disa pozita. Ky është një faktor i rëndësishëm që ka shkaktuar vanesa. Pas këtij problemi, si komunë është dashur të ndërmarrin veprime të nevojshme për të realizuar projektin, dhe kjo ka përfshirë tenderimin e ri të punimeve ku dhe ka mundur vazhdimin e punimeve dhe realisht është finalizuar. Ky pra është një proces i rëndësishëm që mund të kërkojë një rishikim të procedurave të tenderimit, për të siguruar që procedurat ligjore janë ndjekur në mënyrë të saktë. Ju inkurajoj juve që me i bë veprimet e nevojshme po ashtu edhe unë jam i interesuar që me pa se çfarë ka ndodhur dhe po besoj që çfarë do që ka ndodhur ka ndodhur në përputhje të plotë dhe harmoni të plotë me ligjet edhe me atë çfarë është e parapamë vetëm në bazë ligjore dhe të rregullt me u realizu edhe me u punu. Pra e theksova edhe më lartë që kërkoj nga Drejtoria e Financave me e sjell një raport të detajuar në seancën e radhës.

Drita Kadriu: Sa për informim rreth problemit të nxehjes në Shkollën "Migjeni", është e vërtetë që te nxehja ka fillua me u paraqit problemi të premtën pasdite por gjatë vikendit shkolla e ka vërejtë që ka prishje, ka pasur rrjedhje të gypave, të hënën kanë punua shkolla me orar të shkurtuar, ndërsa të martën është evitua problemi dhe shkolla të mërkurën ka vijua mësimin me orar të rregullt, pa asnjë problem. Tash unë e di që po ka edhe protagonist të Facebookave që po bëjnë alarm, mirëpo ai problem brenda dy ditëve është evitua. Ndërsa sa i përket shkollës "Avdullah Shabani" ka qenë premtim mu e rregullua fusha që me u hek lloqi brenda oborrit të shkollës, dhe për këtë shkolla i ka nda mirënjohje znj. Imeri andaj në këtë drejtim nuk besoj që ka ndonjë telashe tjetër.

Kushtrim Zeneli: Në rregull jemi, faleminderit për përgjigjet, mirëpo ajo që unë kërkoja është që kur të ipen 105.000 €, unë mendoj që edhe renditja duhet të bëhet në bazë të prioritetëve.

Elidiana Budini Haziri: Unë kam disa pyetje dhe shqetësime që lidhen me shpenzimet e buxhetit për investime kapitale në riparimin e objekteve të komunës, veçanërisht në lidhje me përmbarimin dhe shpenzimet për ashensorin e komunës. Me sa mbaj mend unë buxhetin e kaluar kemi destinuar para në investime kapitale për merremetimin ose riparimin e objektit të komunës. dhe këtu po shikoj që për objektin e komunës janë paguar 149.000 € po më përmbarues. Njëjtë edhe për ashensorin e komunës, nuk e di a u përfundua, pse su përfundua ende se nuk e kam këtë informacion deri sa këtu po figuron që përmbaruesi i ka marrë 40 535€. Andaj pyetja ime është, A ka ashensor komuna? Apo a është në planifikim me u bërë? Pyetja e dytë është, Pse me përmbarues kur besoj që në buxhetin e kaluar ne veç kemi votuar për riparimin e objektit të komunës? S'e di pse kemi ardhë deri te përmbaruesi.

Nënkryetari i Komunës z.Arian Tahiri: Siç e ceku edhe z.Veseli është një problem që po na përcjell për shkak të kontratave kolektive, edhe po na i marrin mjetet prej kodeve e prej investimeve kapitale. Mandej nuk po mundem me i realizu, pra ashensori nuk është realizu, por mjetet i ka marrë përmbaruesi për pagesa të mësimdhënësve. Gjithashtu, kjo ka ndodhë edhe te disa projekte tjera kapitalesh, do të ndodhë edhe në këtë muaj, se janë të ardhë non stop edhe nuk e dimë ku kanë me u ndalë. Kështu që edhe komuna e Mitrovicës po edhe të gjitha komunat tjera janë duke u penalizu shumë në kuptimin e investimeve në infrastrukturë dhe në të mira publike të përgjithshme, për shkak që këto mjete që po janë destinume për projekte të rëndësishme po u merren përmes përmbaruesit dhe urdhrave përmes thesarit e nuk po mundën mu realizua projektet. Kjo është arsyeja pse janë shpenzua mjetet, puna s'ka ndodhë dhe është shumë e saktë që ti e sheh që janë shpenzua, por s'është punu.

Elidiana Budini Haziri: A mund të dimë sa ka borxh Komuna, a mund ta dimë shifrën e saktë?

Nënkryetari i Komunës z.Arian Tahiri: Jo, nuk dihet. Si derivat i kontratës kolektive nuk është që dihet saktë, nuk e dimë as saktë as na po edhe janë tu ardhë non stop. Deri tash i kemi pagu mbi 3.000.000 €.

Erseka Barani: Unë i kam disa pyetje sa i përket tabelës numër 3, e cila paraqet shtesa për punën jashtë orarit, puna pa orar të paracaktuar, dhe shpenzimet për personelin shëndetësor, ku figuron 3.000€ Shtesat për Punën pa Orar të Paracaktuar, për vëllimin e punës, 3.334€, për nënpunësit e sistemit shëndetësor 10,312 €, Puna gjatë natës dhe jashtë orarit 266,823 € pra për cilën punë jashtë orarit bëhet fjalë edhe për cilët zyrtar bëhet fjalë? kur dihet se orari i punës është 08:00-16:00 a nuk është i mjaftueshëm ky orar, apo janë disa kategori të caktuara që kanë që kanë punu jashtë orarit realisht edhe që ne nuk e kemi informatën. A ka mundësi që ekzekutivi ta na jep sqarime rreth kësaj.

Fahri Shabani: Po përgjigjem për pjesën e shëndetësisë, shtesat për nëpunësit e sistemit shëndetësor, janë disa shtesa të cilat derivojnë nga Ligji i ri i pagave të cilat janë për specialistët e mjekësisë familjare dhe specialistët e tjerë, që punojnë në kujdesin parësor shëndetësor që punojnë vetëm në sektorin publik, jo edhe në sektorin privat. Këta e kanë një shtesë të caktuar e cila ju takon pra e kanë të rregulluar nga ana e ministrisë dhe këtu janë që ata i marrin baza, në vitin e kaluar nuk i kanë marrë në baza mujore por i kanë marrë në baza të grumbulluara për disa muaj dmth për një herë, tash besoj në këtë vit rregullohen dhe i marrin çdo muaj, ashtu siç janë përcaktuar me ligj për kujdestari dhe punë shtesë, unë po flas për pjesën e shëndetësisë, sepse kujdestari mund me pas edhe te sektori i zjarrfikësve ose diku tjetër, për të cilat nuk muj me dhanë informacion. Kujdestari ka, shëndetësia nuk mund me funksionu pa pasë kujdestari. Ka edhe punë shtesë, për arsye se herë pas here shkon personeli shëndetësor në pushime mjekësore, në trajnime, në specializime të cilat duhet mu mbulua me orari po ashtu edhe me orar shtesë. Nëse ju intereson, na mundemi në seancat e ardhshme një raport të detajuar, veç po besoj që e keni të qartë si funksionon.

Erseka Barani: Shërbimet e ndryshme shëndetësore në fq nr 8 Mallra dhe shërbime. Drejtor, janë 64,340 € a mund të na e sqaroni për cilat shërbime bëhet fjalë.

Fahri Shabani: Po besoj që është fjala për shërbimet e kontraktuara shëndetësore, ne e kemi një kontratë që blejmë shërbime shëndetësore me të cilën e ofrojmë kujdesin paliativ, i cili nuk ka ekzistuar ma herët, po tash funksionon. E theksova edhe më lartë nëse jeni të interesuar ne në seancën e radhës e sjellim një raport të detajuar që përfshin këto të dhëna, duke siguruar informacion të qartë për mjetet financiare të shpërndara dhe shërbimet e ofruara.

Erseka Barani: Meqenëse ato mjete janë të taksa pagesve, kishte me qenë mirë që te kemi një raport të detajuar.

Naser Muja: U çekën nga parafolësit thuajse të gjitha, vetëm nuk u çekën që pse kto përmbarime, sa i përket kontratave kolektive është gjithçka në rregull, por jeni zotë qysh fillim të mandatit që nuk do të ketë përmbarime nga operatorët ekonomikë, ndërsa vetëm në këtë periudhë po i shoh që janë marr 400.000 € prej operatorëve ekonomik. Kështu që a ka mundësi me na e sqaru pse po vjen deri këtu situata kur dihet se ka mjete, planifikim pra janë të gjitha.

Nënkryetari i Komunës z.Arian Tahiri: Z.Muja, është dukshëm më ulët se sa që ka pas në të kaluarën, po pse kanë ardhur te kjo pikë është për shkak të intensitetit jo të duhur të operatorëve ekonomikë, ne i kemi nda mjetet që me u finalizu punimet në vitin 2023 dhe x operatori ekonomik nuk i ka realizu punimet në vitin 2023 pastaj ka vazhdu në vitin 2024 dhe pagesa nuk është bërë për shkak se nuk janë përfunduar punimet dhe nuk u bënë pranimi, pra kur kanë qënë mjetet nuk ka mujt të bëhet pagesa dhe kanë mbetur për vitin e ardhshëm, s'ka pas mjete dhe e ka çuar faturën të përmbaruesit i ka marrë, por prap po e theksoj se është dukshëm më pak.

Naser Muja: Po pajtohna që është ma i ulët plotësisht, por edhe buxheti ka një rritje jashtëzakonisht ma të madhe. Për ata keni mundësi me bo planifikim me kohë me shku në mënyrë të rregullt, me shku në mënyrë në bazë të kontratës, pra ju jeni ata që jeni zotuar që nuk do të ketë më më asnjë përmbarues nga investotori.

Veseli Noziri: Unë kisha pas dëshirë që Ramazani me qëllua para zgjedhjeve edhe këtu sot të gjithë e kishin uruar, po qëllor pas zgjedhjeve, andaj edhe para zgjedhjeve, edhe mas zgjedhjeve, unë i falënderoj të gjithë dhe falënderoj zotin që na ka mundësua që ta presim këtë Ramazan dhe të gjithë besimtarëve jua uroj muajin e shenjtë të Ramazanit. Atëherë unë po them që raporti ka ardhur e kemi pa të gjithë dhe për çdo dhe pa çdo pa qartësi ka përgjigje. Unë po besoj dhe po shpresoj që defektet në këtë raport edhe mos realizimi i shumë projekteve po dihet pse, arsyeja është për shkak të urdhërave përmbartimor, pjesa më e madhe është po shihet në drejtim të arsimit.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal Vesa Broja: Nëse nuk ka diskutime të tjera, atëherë kush është që të miratohet Raport financiar për periudhën janar-dhjetor 2024 me pikat të cilat u cekën që të ndryshohen para se të publikohen.

Rezultati i votimit: 20 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Kryesuesja konstaton të miratuar Raport financiar për periudhën janar-dhjetor 2024.

Pika e 6

Oltion Ahmeti: Duke vlerësuar përkushtimin tuaj ndaj çështjeve që preken qytetarët dëshiroj të sjell në vëmendje disa probleme që kërkojnë trajtim të duhur dhe hapa konkretë për përmirësimin e kushteve në komunitetin tonë si janë:

- Vendosja e kamerave përgjatë gjithë liqenit akumulues, të gjithë jemi dëshmitarë të dëmeve që po i shkaktohen këtij liqeni të rëndësishëm për qytetin tonë andaj propozoj instalimin e kamerave të sigurisë gjatë gjithë perimetrit të liqenit për të ndaluar dëmtimet dhe për të mbrojtur këtë aset të rëndësishëm natyror.
- Mungesa e trotuarit në rrugën "Sheqir Avdiu" deri tek stadiumi "Adem Jashari" dhe nevoja për shtrimin e rrugëve me kubëza.
- Rr Mulliri i Vjetër është e pakalueshme dhe ka probleme të mëdha me ujërat e zeza
- Rr "Behgjet Ahmeti" e ashtuquajtura Rruga e Jazit në Zhabar, mbetet e papërfunduar, pusetat e hapura në zhabar përbëjnë rrezik të madh për banorët, sidomos për fëmijët.
- Të bëhet përmirësimi i ndriçimit publik, pasi që në disa rrugë të zhabarit ndriçimi mungon, duke rritur pasigurinë e banorëve, sidomos gjatë natës.
- Pajisja me bexha për asamblistët e kuvendit komunal për një identifikim më të lehtë dhe një transparencë më të madhe në komunikim, pra propozoj që të gjithë asamblistët e kuvendit komunal përfaqësuesit e lagjeve të pajisen me bexha identifikues.
- Përfaqësuesit e lagjeve në Komunën tonë kanë një rol kyç në lidhjen mes qytetarëve dhe institucioneve, pagesa për përfaqësuesit e lagjeve, në bazë të Rregullores për vetëqeverisje lokale. Në shumë komuna të tjera, përfaqësuesit e lagjes kompensohen financiarisht për punën e tyre, propozoj që të shqyrtohet mundësia dhe që përfaqësuesit e lagjeve në Mitrovicë të përfitojnë pagesa simbolike, unë personalisht kërkoj të përjashtohem nga çdo pagesë, pasi këtë detyrë e kam kryer dhe do ta kryer me vullnet dhe pa shpërblim, si përfaqësues i lagjes më të madhe, zhabar i poshtëm. Besoj se këto propozime do të kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve të Mitrovicës.

Armend Begu: E pash vendimin e përfitueseve të bursave, unë jam në komision të ankesave, ju bëj thirrje të gjithë atyre që mendojnë se ju ka bërë të padrejtë të bëjnë ankesë, kemi me shqyrtua secilën veç e veç dhe nëse ka padrejtësi këna me kthi në pikën zero, nuk po du me paragjyku por me pengoj fakti se në fillim të listës së përfituesve pash disa emra të fëmijëve të disa zyrtarëve të partive politike.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja: z. Begu për këtë nuk ka arsye askush të përgjigjet se jeni ju pjesë e Komisionit të ankesve.

Armend Begu: Po jam në komision por akoma nuk kemi mbajtur mbledhje, por unë po inkurajoj që të bëjnë ankesë të gjithë që mendojnë që ju është bërë pa drejtë.

Nafije Rexha: Arsyja pse më shtyu të marr fjalën është se kam dëshirë që të respektojmë njëri-tjetrin kur flasim, dhe të ndihmojmë në krijimin e një atmosfere dialogu. Më erdhi keq nga parafolësi që disa pyetje që i bëri nuk u dëgjuan siç duhet nga opozita. Apeloj që të respektojmë njëri-tjetrin kur flasim, sepse çdo njëri ka të drejtë të shprehet dhe secili që merr fjalën ka një qëllim të qartë.

Nënkryetari i Komunës z.Arian Tahiri: Z. Ahmeti gjitha projektet që përmend janë të rëndësishme, një pjesë e tyre janë duke u trajtuar në lokalitetin e Zhabarit, ndërsa një pjesë tjetër duhet me i parapara e me i fut në buxhet të vitit 2025. Gjithashtu, shumë e rëndësishme pjesa e kamerave, jo vetëm të Liqenit, por gjithë qytetin, sa për informatë jemi në komunikim me Policinë e Kosovës ata kanë një projekt, të cilin na e kanë përcjellë dhe duhet me e planifikua me e fut në buxhet, për shkak që janë shumë të rëndësishme për sigurinë në qytetin e Mitrovicës. Ndërsa, sa i përket pagesave për përfaqësuesit e këshillave të Ligjeve është tej më e rëndësishme, kemi pasur disa takime, e di që edhe ju si përfaqësues jeni tu u merr mirëpo edhe ne si ekzekutivë, përkatësisht Drejtoria e Financave në mënyrë që me modelua e me gjet zgjedhjen që me u bë kompensimi, për çfarë është vullneti e kërkesës së juaj, mirëpo është disponimi edhe i yni me e bë kompensimin për juve, si përfaqësues të këshillave të fshatrave, mirëpo e dimë që pengesa është për shkak ndryshimeve ligjore që ka ndodhë pasi që janë zgjedhur, po duhet me presë parasysh që është aktiviteti i angazhim vullnetar dhe do të bëhet. Kështu që po kërkoj mirëkuptim te kjo pjesë, mirëpo nëse eventualisht e gjejmë bazën ligjore, është disponimi i plotë që me u bë kompensimi edhe për përfaqësuesit e këshillave të fshatrave, pra nëse e gjejmë bazën ligjore, kemi bërë kompensime.

Kryesuesja e Kuvendit Komunal Vesa Broja: ju falënderoj gjithëve për prezencë, ju uroj Muajin e Shenjët të Ramazanit.


Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:35 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

